

Debati regional mbi modelin e KOMRA-s
Forum i gjashtë regional për drejtësinë në transicion
Novi Sad, Vojvodinë/Serbi

20. - 21. 03. 2010.

Pasqyrë e mendimeve, propozimeve dhe rekomandimeve Raport

maj - dhjetor 2009.

1. Hyrje

Që nga përfundimi i luftërave në Kroaci dhe Bosnje e Hercegovinë kanë kaluar 15 vite, ndërsa nga lufta në Kosovë gati 11 vite; numër i vogël i kryerësve të krimeve të luftës është ballafaquar me drejtësinë; mijëra e mijëra viktimë jetojnë në varfëri dhe pa shpresë se jeta e tyre do të jetë më e mirë; ka pak bashkëndjesi dhe solidaritet ndaj viktimave nga bashkësitë tjera etnike, nuk ka dialog social mbi të kaluarën dhe përgjegjësinë personale, nën arsyetimin e integriteteve evropiane, elitat politike avokojnë orientimin drejt të ardhmes dhe harrësës, ndërsa familjet e së paku 16.000 të zhdukurve edhe më tutje gjurmojnë pas varrezave të fshehta të më të afërmeve të tyre.

Duke kërkuar zgjidhjen në favor të të gjithë viktimave dhe gjeneratave të ardhshme, në tetor të vitit 2008, në Prishtinë, Kosovë, në forumin e katërt regional për drejtësinë në transicion pjesëmarrësit e atij takimi kanë krijuar Koalicionin për themelimin e Komisionit Regjional i cili do të konstatojë dhe bëjë publike faktet për krimet e luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të drejtave të njeriut të emëruar KOMRA, e cila sot sot në vete ngërthen 695 organizata jo-qeveritare, shoqata të viktimave, shoqata të familjeve të viktimave dhe individëve. Detyrë e këtij koalicioni regional është të drejtojë debatin mbi

Iniciativën për themelimin e KOMRA-s, ndërlidhë grupe të ndryshme dhe organizata të shoqërisë civile në ndërtimin e ambientit të bashkëndjesisë, solidaritetit dhe respektimit të të gjitha viktimave, t'i përfitojë qytetarët dhe pushtetin për krijimin e KOMRA-s, ndërtojë modelin KOMRA, organizojë fushatën e mbledhjes së *1,000.000 nënshkrimeve për KOMRA*, dhe me 1 qershor 2011, parlamenteve shtetërore të shteteve post-jugosllave t'i dorëzojë iniciativën për themelimin e KOMRA-s.

Nga maji i vitit 2006 kur në takimin e mbajtur në Mal të Zi me përfaqësuesit e shoqatave të viktimave dhe familjarëve të zhdukurve nga shtetet post-jugosllave, u lansua Iniciativa për themelimin e KOMRA-s, deri në fund të vitit 2009 janë mbajtur 79 debate në nivel të bashkësive lokale, nivelin nacional dhe regjional, ndër të cilat janë pesë forume regjionale për drejtësinë në transicion. Në këto debate (konsultime) kanë marrë pjesë 3471 individë nga shoqatat e viktimave dhe familjeve të viktimave, organizatave për të drejtat e njeriut, organizatat e të rinjëve, grupeve të grave, shoqatave të gazetarëve, shoqata të veteranëve, komunitetit akademik, komunitetit të juristëve, qeverisjes lokale dhe organizata e grupe tjera. Në periudhën nga maji deri në fund të vitit 2009 janë organizuar 43 debate në të cilat kanë marrë pjesë 1706 individë. Vlerësohet se deri në fund të vitit 2010 në debate



do të marrin pjesë rreth 5.500 veta, të cilët me propozimet dhe rekomandimet e tyre do t'i kontribuojnë krijimit të modelit KOMRA si përgjegje ndaj nevojës shoqërore për konstatimin e fakteve mbi viktimat dhe rivlerësimin kritik të përgjegjësisë individuale.

2. Kredibiliteti dhe legjitimiteti i Inicativës për themelimin e KOMRA-s

Iniciativa për KOMRA nuk është alternativë e gjykimeve për krimet e luftës të cilat po zhvillohen në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) dhe gjykatat vendore në Ballkan, por paraqet përgjegje ndaj kufizimit në qasje të vërtetës, të kaluarës konfliktuale e cila është e drejtuar ndaj kryesit të krimet. Gjykimet nuk kanë bërë që të fillohet me debatin publik mbi krimet e luftës brenda apo ndër shteteve në regjion dhe as nuk janë pranuar si mekanizma të drejtësisë në transicion e cila mund të jap përgjegje të plotë në pyetjen çka ka ndodhur dhe pse kanë ndodhur krimet.

Iniciativa për KOMRA është një përgjegje lokale, „nga poshtë – lartë“ në nevojën e shoqërisë për ballafaqim me të kaluarën. Legjitimiteti i saj buron nga ndjenja e fortë e përkatësisë brenda organizatave të ndryshme të shoqërisë civile përgjatë tërë ish-Jugosllavisë të cilat kanë ardhur deri në përfundim se interesi i tyre i përbashkët është konstatimi i fakteve për viktimat, krimet e luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të drejtave të njeriut. Viktimat dhe familjet e tyre kanë të drejtë në këtë të vërtetë. Ajo është gjithashtu e nevojshme si mbrojtje nga keqpërdorimet e mundshme të viktimave në të ardhmen për çështje politike të cilat mund të shpiejnë gjithë regjionin në konflikte të reja. Iniciativa për KOMRA është e karakterit regjional që e bënë të jetë shembull i vetëm dhe përgjegje efektive në lidhje me trashëgiminë e konflikteve në ish-Jugosllavi të cilët kanë pasur një karakter transnacional. Është iniciativa e parë post-konfliktuale në nivel regjional për konstatimin e së vërtetës e cila është themeluar ndonjëherë dhe ofron mode-

lin për strategjinë për tu marrë me trashëgiminë e krimeve masive në gjithë globin. Legjitimitet shtesë iniciativës i japin edhe 1,000.000 nënshkrimet për KOMRA të cilat Koalicioni për KOMRA do t'i mbledhë në fushatën që do të zgjasë 6 javë në prill dhe maj të vitit 2011.

3. Përkrahja qasjes regjionale

- Legjitimiteti i iniciativës qëndron në karakterin regjional, mbledhjes së një milion nënshkrimeve dhe në atë që iniciativa vjen nga poshtë, nga baza, e jona për ne.
- Faktet e vërtetuara në nivel të vendit vësh-tirë se mund të jenë të pranueshme në gjithë regjionin.
- Qasja regjionale mundëson largimin nga interpretimet, të cilat cementojnë zgjidhjet ekzistuese politike me të cilat njerëzit janë të pakënaqur.
- E rëndësishme së veçantë është që faktet të dokumentohen, programet arsimuese, librat dhe në edukimin e fëmijëve. Vetëm në atë mënyrë mund të parandalohen interpretimet e ndryshme.
- Qasja regjionale jo vetëm që është e nevojshme, por edhe e pashmangshme. Ajo hap rrugë për ballafaqim me keqbërësit dhe përgjegjësinë individuale.
- KOMRA është e rëndësishme në mënyrë që në Serbi të flitet për viktimat shqiptare dhe në Kosovë të flitet për viktimat serbe.
- Komisioni regjional do të sigurojë faktet mbi të kulluarën mbi bazën e ngjarjeve të cilat kanë ndodhur e që është në interes të gjithë regjionit.
- Vlera më e lartë e KOMRA-s është që të mundësojë të rinjve dhe gjeneratave të ardhshme të kuptojnë gjithë atë që ka ndodhur mbi bazën e tregimeve të njerëzve nga e gjithë ish-Jugosllavia.

- **Për gjeneratat e kohës së luftës, viktimat e huaja nuk janë viktima. Përkrahjen KOMRA-s mund të ia japin vetëm gjeneratat e pasluftës.**
- **Veteran nga Kikinda përkrahin KOMRA-n dhe dëshirojnë të ndihmojnë në përcaktimin e fakteve mbi të kaluarën.**

Legjitimitetin gjithë iniciativës ia jep dimensionin regional. Karakteri regional i iniciativës, debati regional dhe një milion nënshkrimet e mbledhura në të njëjtën kohë i japin legjitimitet dhe kredibilitet.¹

Segmenti i tretë i cili KOMRA i jep legjitimitet është se kjo është iniciativë nga poshtë- e jona për ne, dhe mua më duket se ai është fokusi që e dallon dhe që është argument serioz që ajo të mund të jetë, të them, e suksesshme.²

Ju përshëndes, ju uroj për një iniciativë të këtillë, keni bërë punë të mirë që e keni nisur. Jam anëtar i familjes së të pagjeturve. Sa i përket takimit me anëtarët e familjeve të pagjeturve mund të them se çdo ditë mblidhemi, takohemi (...) Ne që jemi këtu në Kosovë.³

Sa i përket vërtetimit të fakteve, nëse ato vërtetohen vetëm në nivel kombëtar kujtoj se është shumë vështirë se do të përqafohen në mbarë rajonin, e kjo është një pjesë shumë qenësore.

Është esenciale që për luftërat të flitet dhe që faktet të vërtetohen sipas mënyrës e cila do të jetë autentike në vendet e ndryshme. Pastaj, kjo mund të jetë themel edhe për ndërtimin e besimit e ndoshta edhe ndonjë kontribut për pajtimin.⁴

Shikoni atë problem tonin me famë e të qëndrueshëm të qasjes rajonale, unë konsideroj se të gjithë këtu duhet të jemi sa duhet guximtar dhe sa duhet të mençur në këtë proces (...) se do të ishte mirë të shmangemi që ky proces fare ti afrohet interpretimit se ky është çimentim i do farë zgjidhjeje ekzistuese politike. Kjo së pari do të na diskualifikojë neve, së dyti do të fitojë bukur shumë njerëz, sepse

tepër shumë njerëz ka që nuk janë të kënaqur me zgjidhjen ekzistuese politike (...)Ka shumë njerëz të cilët me këtë nuk janë të kënaqur.⁵

Nëse kjo është diç që duhet të jetë detyrë jona primare, që më parë të ballafaqohemi me krimet që janë bërë direct apo ndoshta tërthorazi, krejt është njëjtë, sepse flasim për vendin e përgjithshëm të përgjegjësisë. Mirëpo, nëse, si do të thosha, unë nuk marrë inkurajim nga njerëzit të cilëve u besojmë edhe nga Beogradi, Zagrebi, Prishtina, Podgorica, atëherë kjo detyrë në interpretim të përgjithshëm del tradhti apo tradhti e madhe. Dhe ju thotë – a, po ata. Jo, ata flasin për krimet e veta, apo, e hajde edhe ne për tonin, apo. Qasja rajonale jo vetëm që është e nevojshme, por është edhe e domosdoshme.⁶

Unë e kam marrë për vete tekstin e historisë nga Republika Serpska në BeH, nga Federata e BeH, librin tonë nga Kroacia, nga Serbia dhe bash më interesoj interpretimi i këtyre ngjarjeve, të shpërbërjes së Jugosllavisë. Natyrisht, secili e interpreton sipas mënyrës së vet. Dhe ky është problem, ky është ai problem i cili e ngarkon vërtetimin e të vërtetës dhe prandaj vetëm kjo qasje rajonale mund të jetë rrugë e vetme e drejtë.⁷

(...)ne përkrahim qasjen rajonale, për arsye se mendojmë që qasja rajonale do të kishte efekt ku pjesëmarrësit do ta mandatonin Komisionin i cili do ta interpretonte historinë në mënyrë burimore duke u bazuar në ngjarjet që kanë ndodhur dhe nuk do të lënte anime sipas interesit të shoqërisë së caktuar, por do të ishte në dobi të gjithëve në rajon.⁸

(...)Grupi destinues në të cilin duhet të bazohen në realitet janë njerëzit e rinj. Gjeneratat që kanë dale nga lufta thjeshtë janë të verbra. (...) Të gjithë i kanë plagët e veta dhe hallet e veta, viktimat e veta. Për ata viktimat e huaja nuk janë viktima për të cilat mendojnë. Thjeshtë duan të gjejnë rahat, por në ndonjë zotërim të vetin, të ambientit të vet kombëtar. Ashtu që ata thjeshtë do të luftojnë madje edhe ti mbrojnë personat të cilët e kanë shkaktuar vdekjen e njerëzve tjerë, apo gjenocidin mbi palën tjetër. Ashtu që duhet të orientoheni në vetëdijen e njerëzve të rinj. (...) njeriu i ri (...) mund ti kuptojë

1 Nataša Kandić, Fond për të drejtën humanitare, Beograd, Serbi, Konsultimet nacionale me organizatat jo-qeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

2 Nataša Govedarica, Iniciativa qytetare, Beograd, Serbi, Konsultimet nacionale me organizatat jo-qeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.

3 Fatime Melenica, anëtare e familjes së viktimave, Vushtrri, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqatat e viktimave, Mitrovicë, Kosovë, 5. shtator 2009.

4 Vesna Teršelić, Documenta, Kroaci, Konsultimet nacionale me intelektualë, Podgoricë, Mali i Zi, 17. dhjetor 2009.

5 Ati Mijo Džolan, Instituti Franjevac për kulturë dhe paqe, Split, Kroaci, Konsultimet nacionale me besimtarët dhe bashkësitë fetare, 16. tetor 2009.

6 Zdravko Grebo, profesor, Fakulteti juridik në Sarajevë, BeH, Konsultimet nacionale me intelektualë, Sarajevë, BeH, 7. nëntor 2009.

7 Lidija Lešić, profesoreshë e filozofisë dhe historisë nga Poreçi, Kroaci, Konsultimet lokale me bashkësinë lokale, Pulja, Kroaci, 1. korrik 2009.

8 Ylber Mahxuni, Youth Step, Vushtrri, Kosovë, Konsultimet nacionale me organizatat jo-qeveritare, Prishtinë, Kosovë, 19. dhjetor 2009.

9 Rade Mrden, Partia e Progresit Demokratik, Forumi Rinor, Banja Llukë, BeH, Konsultimet nacionale me të rinjtë, 17 tetor 2009

10 Radan Nikolić, Shoqata e luftëtarëve të luftërave të viteve '90-ta, Mali i Zi, Konsultimet nacionale me shoqërinë civile, Podgoricë, Mal i Zi 18.maj 2009.

11 Nedžad Horozović, Qendra për veprim jo violent, Sarajevë, BeH, Konsultimet nacionale me organizatat jo-qeveritare, Sarajevë, BeH, 21 nëntor 2009

12 Luzlim Arapi, Shoqata për përkrahje psiko-sociale fëmijëve, Gjakovë, Kosovë, Konsultimet nacionale me organizatat jo-qeveritare, Prishtinë, Kosovë, 19 dhjetor 2009

13 Ratko Gajica, përfaqësues në Kuvendin e Republikës së Kroacisë, Konsultimet me bashkësinë lokale, Knin, Kroaci, 4 gusht 2009

14 Lazar Blagojević, Organizata e luftëtarëve të Republikës Serbe, këshilli në Shamac, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, 3. tetor 2009.

14 Monsinjor Marin Srakić, lëshues i Deklaratës së Osijek, Konsultimet me bashkësinë lokale, Osijek, 17. tetor 2009.

*viktimat (...) njësoj të popullit të vetë si edhe të popullit të huaj, pasi që jeta e njeriut është jetë.*⁹

*Për mua është e papranueshme ky model, të kemi komisionet nacionale e më pastaj komisionet nacionale të kenë përfaqësuesit e tyre. Ne këtë e kemi pasur deri më tani. Mali i Zi ka pasur Komisionin për personat e zhdukur. Ky Komision i ka përfaqësuesit në nivel regional. Megjithatë, ata fare nuk marrin pjesë dhe në këtë mënyrë nuk dëgjohet zëri i Malit të Zi, respektivisht familjeve të personave të zhdukur. Andaj, kjo duhet thjeshtë të jetë diçka që është në nivel regional.*¹⁰

4. Qëllimet e KOMRA-s

4.1. Pajtimi

- Pajtimi si proces shoqëror është i nevojshëm në Bosnje dhe Hercegovinë.
- KOMRA ofron shërimin e plagëve dhe mbylljen e dhimbjes, e ky është një hap i nevojshëm drejt pajtimit.
- Në mesin e njerëzve të rëndomtë ekziston vullnet për pajtim.
- Në mënyrë që të vendoset mirëbesimi dhe pajtimi është e nevojshme që të gjithë të dënojnë keqbërjen të cilat i kanë bërë pjesëtarët e komunitetit të tij.
- Gjatë procesit të pajtimit viktimat duhet të falin ndërsa agresori duhet të pranojë fajësinë dhe dëmshpërblimin për veprat e liga dhe dhunën.
- Qëllimi i KOMRA-s mund të jetë pajtimi, por ky është një proces që kërkon dialog, krijimin e hapësirës për rivlerësimin dhe qëndrimet e ndryshme.
- KOMRA ka potencial për ofrim, pajtim dhe zgjerimin e fushëveprimit të interesit të përbashkët.
- Nënata nga Srebrenica i ofendon fjala pajtim

*E kam parasysh edhe atë se pajtimi është çështje individuale dhe se nuk mundet askush askë të detyrohet që të falë diçka apo të pajtohet me diçka, por thjeshtë mendoj se procesi i pajtimit si proces shoqëror i nevojshëm në Bosnje dhe Hercegovinë.*¹¹

*(...) flitet në heshtje në lidhje me rolin e komisionit. A do të duhej të jetë e ndërlidhur me pajtimin apo jo, dhe kjo e gjitha varet nga perceptimi, si dhe në çfarë mënyre. Kjo shihet dhe më duket se është krijuar një averzion, kisha për të thënë i panevojshme, ndaj kësaj që, në fund të fundit, është pozitive për të gjithë. Aktiviteti i këtij komisioni mund të ofrojë atë që ne në gjuhën terapeutike e njohim si shërim i plagëve apo mbyllje të dhimbjes, dhe kjo ka një efekt terapeutik, ndoshta, mund të them, mund të jetë një hap i nevojshëm në rrugën drejt asaj, që si e tillë mund të jetë i gjatë dhe i komplikuar e i cili herët a vonë do të shpiejë drejt pajtimit.*¹²

*Jam i bindur se në mesin e njerëzve të rëndomtë ekziston vullnet për mirëkuptim të kësaj ideje për të cilën ju po flisni dhe thënë troç, në mesin e këtyre njerëzve ka vullnet të madh për pajtim. Atë duhet thjeshtë ta zbulojmë dhe ta sjellim në plan të parë.*¹³

*Doktori Ruzmir Jusufović dhe bashkëshortja e tij (...) kanë qëndruar gjatë gjithë kohës në Shaac ku ka qenë qeverisja serbe dhe e dij se kanë kaluar qaste të vështira sikur edhe doktori Hasan Izetbegović. Ai vetëm pas përfundimit të luftës ka shkuar në Sarajevë. Unë jam i gatshëm të flas në lidhje me padrejtësitë të cilat janë bërë ndaj tyre. Por, deri sa mos të jemi në situatë që të gjithë të dënojmë keqbërjet (...) nga rrethi i tyre, nga populli i tyre, nuk do të ketë mirëbesim në mes nesh. Deri sa ne t'i trajtojmë njerëzit të cilët kanë bërë gjëra të liga si trima, heronjë dhe kështu me rradhë, e në të vërtetë kanë bërë gjëra ç'njerëzore, nuk do të ketë mirëbesim e as pajtim.*¹⁴

Falja në rend të parë është qëndrim i viktimës e cila nuk dëshiron hakmarrje, por të arrijë paqen në shpirtin e saj. Nga ana tjetër dëshirohet të ndërpritet zinxhiri i së keqes dhe hakmarrjes dhe të krijohen kushtet për normalizim të marrëdhënieve. Vuajtja e Krishtit dhe plagët shndërrohen në bashkëvuajtje

dhe me forcën e mëshirimit viktimat e tejkalon preokupimin e tij me dhunën dhe viktimizimin dhe bëhet bartës i porosisë së perëndisë e cila thërret në dialog dhe vendosjen e mirëbesimit (...) falja, dhe pastaj procesi i pajtimit mund të vijë vetëm nga ana të cilët janë të lënduar. Viktima e mbledhë forcën nga përjetimi i mëshirës dhe dashurisë së perëndisë dhe gjenë forcën që prap të vendosë besimin në njerëz dhe të marrë forcën që prap të kthejë besëimin tek njerëzit dhe të tejkalohej dhuna e shkaktuar nga lufta. Apo siç e thonë edhe disa teologë, në mënyrë që të ketë pajtim, viktimat duhet të falin.¹⁵

Nuk është e lehtë ndërmjet palëve në konflikt të gjendet fushë e përbashkët e interesave andaj them sado që ato janë viktimat dhe interesi është që të ndriqohen krimet dhe kryerësit e ndryshëm të cilët po këtyre viktimave u kanë shkelur drejtat e njeriut, ky interes i përbashkët ka potencial të ofrimit të njerëzve, ai madje ka një vlerë diplomatike për shkak se është i karakterit mbikufitar dhe unë besoj se ai edhe pse fillon nga një fakt i cili është i hidhur dhe gjason me një problem juridik, ai me të vërtetë ka potencial të ofrojë njerëzit dhe përhapë fushën e interesit për përbashkët, Ajo që definitivisht është rezultat është ulja e tensioneve.¹⁶

Unë në fillim dua të them në emër të Shoqatës Lëvizjet e Nënave nga enklava e Srebrenicës dhe Zhepës, se ne përshëndesim të gjitha komisionet, jo vetëm këtë komision por cilado që të formohet në Bosnje dhe Hercegovinë dhe jasht saj, sepse gjithmonë është që dikush të punojë diçka se mos të punohet fare. Normalisht që dialogu është i nevojshëm, por më duhet vetëm të them se në gjithë këtë disi më ofendon fjala pajtim. Unë mund ta di që se a do t'ia fali dikujt dhe a do t'ia haroj, por në emër të disa mija nënave unë nuk mund të vendosi (...) Do të thotë, unë do të dëshiroja që ky komision i cili do të krijohet mos ta përmend fjalën pajtim.¹⁷

4.2. Përcaktimi i fakteve mbi krimet e luftës dhe shkaktarët e luftës

- Komisioni duhet të merret me faktet mbi atë se ku, nën cilat rrethana dhe si secila

viktimitë ka vuajtur me emër dhe mbiemër. Gjetja e shkaktarëve na kthen në grupet etnike.

- Kujtimet individuale dhe dëshmitë publike janë esenciale në krijimin e identiteteve të reja politike në Ballkan.
- E vetmja detyrë e komisionit regjional është që të mbledhë fakte. Asesi nuk guxon të lëshohet në cilësimet juridike të krimeve të luftës.
- KOMRA duhet të merret me mbledhjen e të dhënave dhe dokumentimin e jo me interpretimin e fakteve.
- Së pari duhet të përcaktohet faktografija dhe më pastaj konteksti.
- Para dialogut për pajtim duhet të përcaktohen faktet se kush e filloi luftën, pse është bërë luftë dhe cili ka qenë qëllimi i tij.
- Faktet nuk janë të mjaftueshme. Duhet që krimet e luftës të prezantohen në kontekst e një gjë e tillë nuk iu konvenon qeverive.
- Nuk ka përcaktim të vërtetës dhe përgjegjësisë e as pajtimit deri sa nuk të shihen shkaqet dhe pasojat.
- Nëse përcaktimi i fakteve bëhet në deklaratat e viktimave, do të kemi vetëm kryesit e këtyre veprave, nuk do të kemi duhëqësit, iniciatorët e politika dhe drejtuesit e funksioneve shtetërore të cilët kanë qenë organizatorë dhe zbatues.
- Pasqyra e fakteve mbi krimet e luftës nuk është e nevojshme pa analizën e shkaqeve dhe kontekstit, por në rastin e ish-Jugosllavisë kjo do të nënkuptonte kthim në të kaluarën e largët (shekulli XIV)
- Edhe pse vendimi i Tribunalit të Hagës nxjerr shkaktarin dhe karakterin e luftave në ish-Jugosllavi, komisioni nuk do të mund të merrej me shkaktarët.

Ajo se me çka do të duhej të merrej ky komision janë

15 Lazar Stojanović, regjisor nga Beogradi, Serbi, Konsultimet nacionale me organizatat jo-qeveritare, Prishtinë, Kosovë, 19 dhjetor 2009.

16 Munira Šubašić, Lëvizja e nënave nga enklavat e Srebrenicës dhe Zhepës, Sarajevë, BeH, Konsultimet nacionale me organizatat jo-qeveritare, 21 nëntor 2009.

17 Nedžad Horozović, Qendra për veprim jo-violent, Sarajevë, BeH, Konsultimet nacionale me organizatat jo-qeveritare, Sarajevë, BiH, 21 nëntor 2009.

18 Milena Dragičević Šešić, Fakulteti i arteve dramaturgjike, Beograd, Serbi, Konsultimet nacionale me organizatat e grave, politikanet, artistet, gazetaret, Beograd, Serbi, 9. tetor 2009.

19 Hajrija Mujović Zornić, Instituti i shkencave shoqërore, Beograd, Serbi, Konsultimet nacionale me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25. shtator 2009.

20 Dragoljub Vuković, gazetar nga Podgorica, Mali i Zi, Konsultimet nacionale me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17. dhjetor 2009.

21 Biljana Kovačević Vučo, YUCOM, Beograd, Serbi, Konsultimet nacionale me organizatat e grave, politikanet, artistet, gazetaret, Beograd, Serbi, 9. tetor 2009.

22 Željko Špelić, Hrvatski časnički zbor Pakraca i Lipika, Kroaci, Konsultimet lokale me veteranët, Donja Stubica, Kroaci, 28. tetor 2009.

23 Dubravka Špančić nga Pakraca, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, Kroaci, 22. shtator 2009.

24 Brano Mandić, Vijesti, Mali i Zi, konsultimet regionale me gazetarë, Novi Sad, Serbi, 26. shtator 2009.

25 Senad Pećanin, Dani, BeH, Konsultimet regionale me gazetarë, Novi Sad, Serbi, 26. shtator 2009.

faktet të cilat bazohen në, ta them në atë mënyrë, në një hapësirë të ngushtë, e ajo është: ku, nën cilat rrethana dhe si kanë vuajtur secili me emër dhe mbiemër. Nëse hyjmë në interpretime, hulumtimin e arsyeve pse çfarë arsye çka ka ndodhur, ne detyrimisht prap do të kthehemi në grupet tona etnike.¹⁸

Në këtë kuptim mua më duket se insistimi në faktet precize dhe momeries individuale, në kujtimin individual e cila është e dhimbshme për ne të dëgjohej është shumë e rëndësishme. Kur nëna Mejra foli ishte shumë e rëndësishme të dëgjohej, është më së vështiri të dëgjohej dhe është më domethënëse të dëgjohej historinë personale se sa arsyeshmërinë teorike të shkaqeve, pasojave, mijërave, milionave pastaj këto numra pushojnë së paturi çfarëdo ndikimi. Më duket se shënimi i kujtimeve individuale, dëshmitë e pandërprera publike mund të kenë rëndësi kryesore në krijimin e një baze të re për zhvillim të identiteteve politike të të gjitha shteteve ballkanike.¹⁹

Propozoj që ne të fokusohemi në ngjarjet dhe në mbledhjen e dokumenteve dhe mos t'i përcaktojmë vetës (...) qëllime tepër të mëdha, sepse, thjeshtë, do të futemi në grackën që ato qëllime nuk do të mundemi as t'i arrijmë.²⁰

(...) a duhet që ky komision të ketë mandat të përcaktojë kontekstin. Unë do të dëshroja ta ketë por mendoj se nuk duhet ta ketë. Por konteksti nënkuptohet. Mund të jetë në ndonjë hap tjetër përcaktimi i kontekstit. Së pari duhet të kemi faktet. Do të thotë së pari duhet dhënë përgjegje në pesë pyetjet, tani më po sillem si trajner i gazetarisë. Duhet të vërtetojmë faktografinë e më pastaj do të përcaktonim atë se cila është e vërteta, pas kësaj duhet siguruar konteksti. E kush do të përcaktojë kontekstin, historianët e ndershëm, intelijenca e ndershme etj. por ai kontekst duhet të përcaktojë për ata, prap për hirë të gjeneratave të ardhshme duhet ditur pse ajo ka ndodhur.²¹

Nëse arrijmë deri te e vërteta dhe nëse krijohet komisioni regional për të vërtetën, e vërteta nuk është e barabartë me faktet. Do të thotë, faktet e vendosura pa ndonjë kontekst nuk do të thojnë asgjë, por konteksti është ai i cili spjegon se si

kanë rrjedhur gjërat dhe si viktima e gjenocidit të Srebrenicës është viktimitë dhe viktima e bombardimit të NATO-s është viktimitë, këtu është çështja. Do të thotë nuk ka përcaktim të vërtetës dhe përgjegjësisë e as pajtimin në region deri sa nuk të përcaktohen shkaqet dhe pasojat.²²

Kush janë kryesit? Nëse e vendosim tregimin në viktimitë, nëse viktima do të prezantohet atë se si e sheh vuyajtjen e saj në fund do të kemi se vetëm numër i vogël i njerëzve kanë qenë viktima dhe se kryesit janë ata të cilët e kanë kryer krimin, nuk do të arrijmë deri tek udhëheqësit, iniciatorët e politikave, drejtuesit e funksioneve shtetërore të cilët kanë organizuar dhe kanë qenë bartësit, do të thotë se nuk e kemi arritur qëllimin të cilin e kemi dashur.²³

Mua personalisht më mungon fjalia kush dhe kur ia ka nisur lufta. Mendoj se pa të, deri sa nuk të ketë trimëri që ky tanks i APJ-së i cili ka hyrë në Pakrac dhe ai fqinji (...) e ka marrë pushkën 1. 03. 10091 dhe ka sulmuar stacionin e policisë (...) në Pakracin kroat mund të thotë „po, ne ia kemi nisë, jemi gati të vazhdojmë tutje“... Unë jam katolike, jam e gatshme me ia falë kur të ma zgjasin dorën. (...) dhe nuk po më pëlqen opcioni që fillimi është në Beograd. Pirolla iu qoftë, por nëse pas kësaj qëndron fakti që jeni të vetëdijshëm për atë që ka ndodhur.²⁴

Unë jam një pesimist i madh sepse e di kur është krijuar fuqia e dijmë si është krijuara paraja dhe atyre strukturave (politikanëve) e vërteta nuk iu konvenon (...) Në Mal të Zi para tre, katër viteve (...) është xhiruar një film dokumentar (...) i cili ka trajtuar agresionin në Dubrovnik. Në atë film çdo gjë ka qenë e bishtnuar nga faktet (...) Megjithatë dimenzioni politik i gjithë atij marshimi në Dubrovnik (...) nuk ekziston fare. Kështu që me një qasje bazuar në fakte ka ardhur deri tek ajo që doli në njerëzit me mjekkra dhe të dehur kanë hyrë në trashëgiminë botërore të udhëhequr me një energji antike e të ngjajshme. Po e përshkruaj në këtë mënyrë qëllimshëm (...) dua të them se ai kontekst duhet të shfaqet përmes asaj se si do të përputhen faktet, gjë që këtyre nuk iu konvenon.²⁵

Mina tjetër shkelëse (...) është dilemma a do të merret ky komision rajonal vetëm me faktet apo edhe me shkaqet. Nëse është fjala për faktet (...) mendoj se (...) aty nuk ka shumë të panjohura, pavarësisht nëse rastin për paraqitjen e të vërtetës dhe të përvojës së vetë e kanë vetëm viktimat apo edhe kryesit e krimit (...) Natyrisht se pasqyra e atyre fakteve tek të cilët mund të vihet nuk do të ishte (...) e mundshme as për së afërmi në shkallën në të cilën është e dëshirueshme dhe e nevojshme pa analizën e shkaqeve të atyre ngjarjeve (...) E në qoftë se nisemi me kontekst, atëherë (...) nisemi me historinë (...) Unë jam absolutisht i sigurt se sikur do të niseshim me analizën e shkaqeve apo pasqyrimin e kontekstit (...) do të shkonim deri në shekullin e XIV. Unë thjeshtë nuk shoh në territoret e shtetit tonë, as ambient akademik, as një ambient në shoqëri ku është e dëshirueshme lidhja faktike e historisë.²⁶

5. Mandati KOMRA-s

5.1. Mbikëqyrja kohore

- KOMRA nuk duhet të kthehen në të kaluarën e largët. Inkuadrimi i ngjarjeve të para vitit 1989 do t'i relativizonte krimet. Raporti duhet të paraqesë krimet sipas komunave ku ato kanë ndodhur.
- KOMRA nuk duhet të kthehen në të kaluarën e largët.
- KOMRA duhet të përfshijë periudhën e përgatitjes së luftës.
- Për Kroacinë është e rëndësishme të fillojë hetimet nga viti 1990 sepse Mbrojtja territoriale është çarmatosur në vitin 1990 dhe mitingjet e urrejtjes dhe fjalët urrejtëse në media kanë filluar në vitin 1990.
- KOMRA duhet të mbulojë kohën e cila i ka paraprirë konfliktit të armatosur të vitit 1991.
- Nuk mund të kthehem në shkullin e 18

apo 19 por duhet të fillojmë me 20 vitet e fundit.

E tash kur është fjala për periudhën kohore propozimi im është që kjo të jetë periudha 1991 – 2001. Pra të mos jetë viti përfundimtar viti 1999 por të jetë viti 2001, e kjo do të ndërlidhë këtu me territorin e punës së Komisionit për shkak se ai duhet, natyrisht, të merret me ngjarjet edhe në Slloveni dhe në Maqedoni. Vitin 2001 pikërisht e përmenda për shkak të ndodhive në aqedoni që përafësisht kanë qenë atëherë, dhe natyrisht për hartimin e raportit final dhe për veprim nëpër komuna ku kanë ndodhur krimet e luftës.²⁷

Të shkohet me këtë në të kaluarën e largët, në vitin 1800 apo ndonjë vit tjetër. Kjo është zbutje e përgjegjësisë për atë (...) që ka ndodhur para disa vitesh në këto hapësirat tona. Për mua kjo fare nuk është e afërt, prandaj do të sugjeroja (...) që të mos shkojmë larg, se do t'i hulumtojmë Ilirët (...) e nuk do ta (...) kërkojmë përgjegjësinë e atyre atje të cilët kanë bërë vepra të këqija sikurse janë bërë në vendin tonë.²⁸

Bie fjala në Srebrenicë tri vjet para se të filloj lufta, i hapën rrugët nëpër mal. Pse po hapën rrugët nëpër mal? Thotë, po duan të eksportojnë dru. Përgatitjet janë bërë. E transferuan armatimin territorial nga Srebrenica. Burri im ka qenë intelektual. E ka ditur çka do të thotë kjo. E pyet Sava Aleksiqin krye-shefin e Sekretariatit të Punëve të Brendshme të Komunës: 'Çka po bëjnë këtë Savo?' Thotë: 'Ndoshta janë vjetruar. Po duan ti zëvendësojnë.' Mirëpo e lanë qytetin pa mbrojtje. Kjo ka qenë përgatitje. Dhe duhet të nisemi nga këto fakte edhe në KOMRA për të konfirmuar përse na ka ndodhur e gjithë kjo. Dikush këtë e ka planifikuar paraprakisht.²⁹

Për këtë shkak është jashtëzakonisht esenciale për Kroacinë që të përcillet prej vitit 1990. Përse prej vitit 1990.? Jo vetëm pse Kuvendi e ka miratuar Deklaratën mbi Luftën Atdhetare, jo vetëm pse në Ligj prej vitit 1990 deri më 1996 trajtohet se ka qenë luftë në kuptimin e ngushtë të fjalës, veç për shkak se atëherë është bërë çarmatosja e Mbrojtjes Territoriale, që është esenciale sepse kjo në realitet gjithë

²⁶ Dragana Nikolić, Këshilli për iniciativë qytetare, Nish, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zaječar, Serbi, 22 dhjetor 2009.

²⁷ Salih Rasavac, Corridor, Sarajevë, BeH, Konsultimet nacionale me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.

²⁸ Kada Hotić, Lëvizja e nënave nga enklavat e Srebrenicës dhe Zhepës, Sarajevë, BeH, Konsultimet nacionale me grupet e grave, Tuzla, 11 nëntor 2009.

²⁹ Ljiljana Canjuga, UDVDR PGZ, Kroaci, Konsultimet lokale me veteranët, Donja Stubica, Kroaci, 28. tetor 2009.

30 Teki Bokši, avokat nga Kosova, Forumi i pestë regjional për drejtësinë në transicion, Budvë, mali i Zi, 29.-30. maj 2009.

31 Amir Kulaglic nga Srebrenica, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10. tetor 2009.

32 Rexhep Lushta, Bashkësia Islame në Mitrovicë, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile Mitrovicë, Kosovë, 29. tetor 2009.

33 Dubravka Špančić nga Pakrac, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, Kroaci, 22. shtator 2009.

34 Marija Lovrić, viktimë nga Osijek, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Osijek, Kroaci, 17. tetor 2009.

35 Željko Pinjuh, qytetar nga Vukovari, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Osijek, Kroaci, 17 tetor 2009

*Kroacinë e trajton si viktimë. Sepse nëse dikujt ia merrni mundësinë të mbrohet, atëherë ai automatikisht në raport me dhunën e veprimin ndaj vetes dhe dëmit që ka përjetuar, bëhet viktimë, sido që ta kthejmë. Nga ana tjetër edhe mitingjet edhe fjalët e urrjetjes edhe ndryshimet në media janë bërë më 1990, më pas vetëm është çështje e superstrukturës.*³⁰

*Në Kosovë duhet të mbulohet periudha kohore nga 11 marsi 1981 kur një student në menzën e studentëve e ka hedhur pijatën në kohën kur ka ardhur stafeta e Titos në qendër të Prishtinës dhe aty është kërkuar që Kosova të fitojë statusin e republikës dhe nga ana tjetër ai student ka brohoritur poshtë Tito... ashtu që në esencë konflikti i armatosur në Kosovë ka filluar më 11 mars 1981 dhe për mendimin tim ka përfunduar më 9 qershor 1999 kur është nënkruar Marrëveshja e Kumanovës.*³¹

5.2. Vrste krënjja

- **Komisioni duhet të merret me vrasjet, dëbimet, dhunimet, torturat dhe qendrat e ndalesës dhe mbajtjes.**
- **KOMRA duhet të merret me fatin e të pagjeturve dhe viktimave të dhunës seksuale dhe psikologjike.**
- **KOMRA duhet të merret me fatin e personave të ngjuar dhe të zhdukur në Vukovar dhe gjurmimin kundër kryerësve të këtyre veprave të rënda.**
- **Në Kroaci nuk flitet për krimet të cilat janë bërë në Osijek e disa viktimat nuk kanë as drejtë në dëmshpërblim.**
- **Është e nevojshme që KOMRA të hetojë dëbimin e shqiptarëve dhe rrënimin e objekteve të tyre në Kikindë gjatë bombardimit të NATO-s.**
- **KOMRA duhet të merret me shkeljet e drejtave të njeriut në Sanxhak gjatë viteve '90-ta.**
- **KOMRA duhet të përfshijë edhe krimet të**

cilat forcat serbe i kanë kryer ndaj shqiptarëve në Luginën e Preshevës gjatë periudhës së konfliktit me Ushtrinë Çlirimtare për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje.

- **Në mandat të komisionit duhet të inkua-drohet mobilizimi i dhunshëm i refugjatëve dhe qytetarëve të Serbisë.**
- **Shqiptarët bartin barrën e përgjegjësisë për dhunën e vitit 2004.**

*Këtu u përmendet krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të drejtave të njeriut. Por, në të vërtetë cilat janë në të vërtetë ato shkelje... Mbi të gjitha janë vrasjet. E dyta janë dëbimet. E treta janë dhunimet. E katërta janë viktimat e terrorit në qendrat e ndalesës dhe mbajtjes.*³²

*KOMRA përveç asaj se duhet të merret me identifikimin e personave të zhdukur, nuk duhet të anashkaloj edhe çështjen e viktimave të dhunës, qoftë dhunës psikike, qoftë edhe dhunës seksuale.*³³

*Kemi njerëz tanë, pakracasit të cilët nga Kostajnica janë dërguar në Manjaçë, Bjelinë, vukovaras të zene rob në Mitrovicën e Sremit, kurrë s' kam dëgjuar se (...) dikush është proceduar nga ato territore. (...) Unë e di se komisioni do të jap përgjigje pikërisht në këto pyetje.*³⁴

*Askush nuk i përmendi krimet e luftës në Osijek, thua se ne na ka kapluar harresa! Ne nuk e mbajmë mend se kjo ka ndodhur apo nuk duam t'ia pranojmë vetvetes. Unë nuk di... Në këtë shtet askush nuk e ka shtruar pyetjen "po ku janë ato familje, çfarë ka ndodhur me ata fëmijë, a kanë shkuar ata fëmijë në shkollë, a kanë tash punë, a kanë pasur fare çka të hanë?" Për këtë askush nuk ka shfaqur kujdes. Në rrugën time ka 33 shtëpi. Të gjitha janë të thyera. Nga e para deri të e fundit. Dhe të gjithë kanë marrë dëmin luftarak, vetëm unë në këtë nuk kam pasur të drejtë. Për çka? (...) Mua ma kanë shkruar se nuk kam të drejtë.*³⁵

Neve edhe na gëzon që ky KOMRA, të paktën kur t'ia dilte ta gjejë fatin edhe të vetmit të burgosur apo

të zhdukurit nga Vukovari, apo nga territory ynë, dhe ta sjellë përpara drejtësisë edhe një kriminel kuptohet me prova, ne banorët e Vukovarit këtë do ta përshëndesnim.³⁶

Në fillim të bombardimeve, më 1999, shumë lokale afariste të qytetarëve të Kikindës të nacionalitetit shqiptarë kanë pësuar dhe janë djegur, qytetarët shqiptarë janë dëbuar dhe thjeshtë dikush është dashur të jetë urdhërdhënës që masa të detyrohet të shkatërrojë ato objekte. Mendoj se duhet të hetojmë në Kikindë se kush kanë qenë ata urdhërdhënës, kush kanë qenë ato grupe e individ që e kanë nxitur masën ta shkatërrojë pronën e qytetarëve shqiptarë.³⁷

(...) nuk duhet me i bë bashkë ngjarjet e vitit 2004 me ngjarjet e luftës. Për vitin 2004 ne jemi fajtor, ne e kemi bërë, ne jemi përgjegjës edhe për kisha, edhe për shtëpia dhe për të gjitha ato përgjegjës jemi ne dhe atë barrë duhet ta bartim ne. Ne edhe prej luftës duhet të mësojmë, duhet me marrë mësim se çka nuk guxojmë të bëjmë, çka nuk guxojmë me i bë një etniteti tjetër.³⁸

(...)(...) Nuk janë vetëm krimet e luftës që kanë ndodhur në hapësirën e ish Jugosllavisë në periudhën prej vitit 1991 deri më 1999. Për shembull çfarë ka ndodhur në Sanxhak po ashtu në vitet e 90-ta. Këto nuk kanë qenë direkt krime të luftës, por ju e dini se atje njerëzit, kryesisht të nacionalitetit mysliman, kanë qenë të munduar nga ana e pjesëtarëve të policisë, jo të formacioneve paramilitare, kjo dihet saktë, pos tjerash edhe të paramilitarëve. Mirëpo policia i ka marrë në pyetje njerëzit i ka shoqëruar në biseda informative e kështu me radhë. Kjo po ashtu është një vepër e cila duhet të jetë e dënueshme, nuk është krim direkt i luftës, por unë mendoj se Komisioni duhet të merret me këtë problem.³⁹

Nuk e di sa është future në këto rrjedha edhe Lugina e Preshevës, sepse edhe atje ka pasur krime të mëdha, shumë njerëz janë zhdukur dhe nuk dihet se ku kanë përfunduar. Do të thotë duhet të përfshihet Lugina e Preshevës, Presheva- Bujanovci dhe Medvegja. Aty ka pasur një luftë përafësisht njëvjeçare, ndoshta s'ka qenë ose si doni e quani atë, por ne e quajmë si luftë, sepse ka familje shumë

anëtarësh që janë zhdukur ose janë vrrarë, kështu që edhe ajo është një lloj lufte. Kisha dashur të dij a do të futet në komisioni edhe kjo pjesë.⁴⁰

Propozoj që të radhitet edhe një krim i luftës, e ky është mobilizimi i dhunshëm i refugjatëve që është bërë në Serbi, dhe ne për këtë, sa kemi mundur, kemi mbajtur një evidencë shumë të saktë. (...) vik-tima duhet të jenë të gjithë meshkujt që janë mobilizuar dhunshëm. Gjithashtu është rekomandimi që të shihet nëse këto shtetet dëshirojnë të thonë sa të rinjtë kanë qenë të mobilizuar dhunshëm.⁴¹

5.3. Autorizimet

- **KOMRA duhet të ketë mandat të hetojë rolin e individëve dhe institucioneve.**
- **KOMRA duhet të jetë e pavarur nga ndikimet politike dhe të ketë fuqinë të lëshojë shkresa obliguese për të gjithë dëshmitarët.**
- **Pjesëmarrësit janë të ndarë rreth amnestisë së kryesve të krimeve të luftës: disa janë kundër e disa vlerësojnë se KOMRA mundet të jap rekomandime organeve gjyqësore, por jo edhe amnestinë.**

Me çka do të merret ky komision, me individët apo me institucionet? Mendoj se pikë së pari është me rëndësi të merret me institucionet që do të sjell edhe tek individët të cilët kanë bërë gjëra të tilla.⁴²

E dini se disa nga këto krime i kanë krijuar mediat? Ju kujtohet para luftës, ju kujtohet çka shkruhej mbi Kosovën? I gjithë ai orkestrim ka ndodhur me anë të mediave. Pra, ato kanë qenë politike, shumë kriminel janë manipuluar.⁴³

Mandati (...) konsideroj se nuk duhet të jetë i kufizuar për veprim vetëm në individët, por edhe në institucione. Individët janë kryes (ekzekutor) dhe këto janë vetëm figura të shahut në tërë sistemin. (...) A mundet KOMRA në kohë të afërme, pas paraqitjes së fakteve, ta ngre edhe çështjen e rolit të institucioneve. Historia do të ishte boshe nëse do

36 Nenad Talijanov, Forumi i Kikindës, Kikindë, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Kikindë, 17 tetor 2009

37 Musa Mustafa, Koha Ditore, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, 29 tetor 2009

38 Dragana Nikolić, Këshilli për iniciativë qytetare, Zajeçar, Serbi, 22 dhjetor 2009.

39 Nexharie Islami Pllana, Dona, Mitrovicë Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, 29. tetor 2009

40 Staša Zajević, Gratë në të Zeza, Beograd, Serbi, Konsultimet nacionale me grupet e grave, Podgoricë, Mali i Zi, 23 tetor 2009.

41 Zekerijah Hadžić, Asociacioni i studentëve Srebrenicë, BeH, Konsultimet lokale me bashkësinë lokale, Zvornik, BeH, 18, korrik 2007.

42 Dževdet Hadžiselimović, Shoqata Protogora, Poreç, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pula, Kroaci, 1. korrik 2009.

43 Nevena Kostić, Gratë për Paqe, Leskovc, Serbi, Konsultimet nacionale me organizatat e grave, politika-neve, artisteve, gazetarëve, Beograd, Serbi, 9. tetor 2009.

44 Željko Hodonj, HINA, Kroatia, Konsultimet regionale me gazetarë, Novi Sad, Serbi, 26. shtator 2009.

45 Đorđe Radanović, Qendra për afirmimin e të rinjëve Shekoviqi, BeH, Konsultimet nacionale me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17. shtator 2009.

46 Marko Grabovac, Organizata e republikës përs për kërkimin e të zënëve peng dhe luftëtarëve të pagjetur i Republikës Serbe Brod, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, 3. tetor 2009.

47 Saša Radovanović, Instituti për kulturën serbe, Krushevc, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, 7 shtator 2009.

48 Šefika Muratagić, Shoqata Qelësi i ardhmërisë, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10. tetor 2009.

49 Nexharija Islami-Pllana, Dona, Mitrovica/Mitrovicë, Kosovo, Lokalne konsultacije sa civilnom društvom, Mitrovica/Mitrovicë, Kosovo, 29. oktobar 2009.

50 Miroslav Varga, brantelj iz Osijeka, Hrvatska, Konzultacije s lokalnom zajednicom, Osijek, 17. listopada 2009.

51 Lazar Blagojević, Boračka organizacija Republike Srpske, odbor u Šamcu, BiH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BiH, 3. oktobar 2009.

52 Alija Dautović, Udruženje žrtava rata Vlasenica 92 – 95, Tuzla, BiH, Konsultacije sa lokalnom zajednicom, Vlasenica, BiH, 14. novembar 2009.

*të mbeteshin vetëm individët që kanë krye krime, nëse prapa kësaj nuk shihet qartë frymëzimi i gjithë kësaj. Kuptohet edhe roli i kishës edhe i arsimit, të gjitha aspektet e shoqërisë tonë. Nuk ekziston vend bosh në sistemin tone shoqëror i cili nuk ka pasur rol në nxitjen e luftës dhe të urrejtjes luftarake.*⁴⁴

*Kolegu (...) shtroi një tezë të rëndësishme (...) duke hapur bisedën për hulumtimin e rolit të mediave gjatë viteve të nëntëdhjeta (...) Hulumtimi i rolit të mediave gjatë viteve të nëntëdhjeta është i rëndësishëm, por është me rëndësi të konstatohet roli i mediave edhe për atë periudhë para viteve të 90-ta kur në realitet nisi orkestrimi i ngjarjeve.*⁴⁵

*Edhe ne këtu tash mund të formojmë komisionin, dhe t'i ftojme dëshmitarët të dëshmojnë e ai thotë "s'dua" (...) Vërtetë lypset të jetë i pavarur (...) nga të gjitha ndikimet e mundshme politike, e nga ana tjetër nevojitet të ketë instrumente të detyrimit. Kur ai komision ta gjejë të nevojshme se duhet të dëshmoji ai dhe ai person, domethënë që edhe automatikisht mund të jap urdhëresën për shoqërimin e atij personi që të vijë, do me thënë që ai të dëshmojë e që atë urdhëresë nuk mund ta bllokojë ndonjë institucion tjetër në kuadër të shtetit.*⁴⁶

*Nuk ka amnesti për askë i cili e ka kryer atë krim.*⁴⁷

*Sa i përket amnistisë (...) unë këtu jam rigoroz kundër (...) që ai komision të jap Rekomandime, por të marrë vendime (...) këtu tash shtrohet çështja e kompetencës së trupit dhe unë mendoj se këtu veç hymmë në kompetencën e organeve juridike dhe kjo tash më (...) është një çështje serioze juridike (...) kujtoj bile se është edhe çështje etike (...) Kjo amnesti, në realitet mund të jetë rekomandim.*⁴⁸

*Megjithatë, të lëshohet në atë se mandati të jetë amnestia, me të vërtetë mendoj se ky nuk do të duhej të ishte mandati i këtij komisioni.*⁴⁹

*Sa i përket amnistisë, apo lehtësimit të dënimit, në qoftë se është fjala për kryerësit e veprave, unë mendoj se ata s'duhet as të amnistohen, as t'u lehtësohet dënimi.*⁵⁰

6. Aktivitetet e veçanta të KOMRA-s

- KOMRA duhet të evidentojë të gjithë viktimat, me emër dhe mbiemër, dhe të dihet se si kanë vuajtur.
- Zgjedhja e fatit të pagjeturve
- Komisioni duhet të bëjë regjistrimin e viktimave dhe kryerësve të veprave
- Regjistrimin e të burgosurve politik gjatë periudhës së komunizmit dhe konfliktit të armatosur
- Regjistrimin e të ndaluarve dhe burgosurve në objekte të ndryshme në mënyrë të kundërligjshme
- Komisioni duhet të përgatisë antologjinë e teksteve të gazetarëve të cilat kanë përgatitur materializimin e idesë që ka shpie drejt kimit
- Regjistrimin e viktimave gjatë bombardimit të NATO-s si dhe përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë deri tek bombardimi

*Ajo që mendoj se është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe për çka unë këtë koalicion e kam përqaftuar edhe këtë iniciativë e shikojë si diç që është shumë me rëndësi, është që të shënohen viktimat. Ne kemi të shënuara veprimet nëse i gjejmë ditarët e topçinjve, do ta kemi edhe këtë. Kemi të regjistruara emisionet televizive, i kemi të shënuar nxitësit, kemi të regjistruara tekset gazetareske. Çdo gjë në këtë luftë është regjistruar, vetëm viktimat askund nuk janë regjistruar.*⁵¹

*Mendoj se përfundimisht ka ardhur koha që pas 14 vjetësh, si në këto hapësira të Bosnjës e Hercegovinës ka pushuar lufta ... Të vijmë deri tek e vërteta, respektivisht që të gjitha viktimat të regjistrohen saktësisht me emër e mbiemër. Dhe mendoj se ky është rol i KOMRA -s. Nëse nuk mund të vijmë tek të dhënat e sakta mbi kryesit, të paktën mund të sigurojmë të dhënat kush dhe si ka pësuar.*⁵²

Të gjenden të gjithë që janë zhdukur, vrarë dhe të varrosën me dinjitet. Dhe tjetër, që të identifikohen dhe dënohen kriminelët e luftës (...) të gjithë ne dëshirojmë që në njëfarë mënyre të tregohet e dësh-mohet përse ka ndodhur kjo dhe kush e ka iniciuar që të ndodh e gjithë kjo.⁵³

Do të donim t'u mbështesim në këtë iniciativë në emër të anëtarëve të familjeve të pagjeturve dhe-dashtë Zoti që me bashkëpunimin tonë dhe tuaj të përbashkët, si dhe të qeverisë tonë, t'i gjejmë të pagjeturit tanë (...) Dëshira më e madhe dhe pasu-ria më e madhe do të ishte ta gjejë babën tim, ta dijë ku e ka varrin.⁵⁴

(...) Është më mirë që ai i cili ka krye krim të thotë ku janë trupat që ne familjarët të qetësohemi. Nuk është e domosdoshme që unë ta padis askënd (...). Le të mi jap eshtërtat, fëmijën. Dhe ashtu të kënaqura do të ishin të gjitha këto familje nga ana ime, që të gjenden mbetjet mortore dhe të varrosen me dinjitet.⁵⁵

Pajtohem se (...) ky komision duhet ti emërtojë kryesit e krimeve të luftës, sepse megjithatë, ... Nëse i emërtojmë viktimat, kundruall kësaj le të kenë edhe ata që i kanë kryer ato krime të luftës pavarë-sisht nga cili popull vijnë.⁵⁶

Një ndër viktimat të cilat mund të japin fakte direkte për çdo gjykim apo kundër shtetit e cila ka ndërmar-rë vepra kriminale të cilat nuk janë të përfshira në konventat ndërkombëtare janë të burgosurit politik. (...) Mendimi im është se pika e parë do të ishte që komisioni apo kusshdo qoftë tjetër të formojë një komision që do të merrej me të burgosurit politik.⁵⁷

Kam qenë robër në kampin Buçje, por para këtij kampi Buçje ka qenë një kamp në Grgjevic për të cilin ndoshta askush nuk ka ditur nga këto pushte-te, vetëm kanë ditur disa njerëz, ata kriminelët që na kanë mbyllur atje (...) Sekret, për të cilët nuk ka ditur askush përpos partisë, të këtyre "serbomëd-henjve", si do ti quaja unë ata, apo jo serbët (...) dhe atje duhet vendosur një tabelë.⁵⁸

(...) të tri palët në Bosnjë e Hercegovinë kanë sho-qatat e kampistëve, mendoj se do të ishte mirë që të

tri palët ta shkruajnë çka është definicioni e kampit dhe përse ata konsiderojnë se atje ku kanë qenë të zënë rob janë kampe, por pastaj ai definicion që e kanë shkruar ata, nënkupton se në qoftë se edhe pjesëtarët e popullit të tyre respektivisht të entite-teve të tyre kanë organizuar diç të tillë, që kjo po ashtu të konsiderohet kamp. Domethënë, jo vetëm ku kam qenë unë veç edhe dikush nga ana ime këtë e ka organizuar, atëherë kjo po ashtu konsiderohet kamp. Mendoj se propozimi im, ai definicion, është mënyrë sipas të cilës mund të zgjidhet kjo pyetjeçka është qendra e grumbullimit e çka kampi? Dhe konsideroj se duhet shënuar të gjitha vendet e pësi-meve sikur që janë shënuar pas Luftës së II Botërore kampet, sidomos siç janë Jasenovac, Aushvic etj. (...) çdo krim të luftës pavarësisht nga cila anë është kryer, unë e gjykoj dhe do të më vinte mire në qoftë se në vendosjen e pllakës përkujtimore në Stajiqevë vinë edhe ato viktimat e Lorës (burgu), e po ashtu nëse ata vendosin një ditë ta vënë pllakën përkuj-timore në Split, në Lora, do ta kenë mbështetjen time.⁵⁹

E përshëndes iniciativën, sepse pavarësisht sa kemi punkte të tilla që merren me këtë çështje, gjithmonë ka pak, ngase krimi është planetar. Sipas meje do të duhej që ky institucion (KOMRA) ta hartojë antologjinë e teksteve të gazetarëve të cilët janë luftë nxitës, kriminel, të cilët i përgatisin shpirtrat për materializimin e idesë. Jam për atë që të futet, nëse mundet, një klauzolë e shkurtër mbi ata gazetarë dhe të hartohet antologjia, antologjia empirike që është representative dhe të shihet qartë se si dikush i ka përgatitur shpirtrat për disa gjëra.⁶⁰

A është mandate i KOMRA, sipas ndonjë ideje, të shkojë në atë drejtim që të shtrihet në pyetje e përgjigje, domethënë në viktima dhe shkaqet e bombardimeve që kemi pasur nga Pakti NATO? Mendoj se shembulli i RTS është shumë i mirë, kemi edhe shkaqet edhe pasojat për ta vëzhguar dhe parë fajësinë edhe nga ana jonë edhe nga ana e atyre tjerëve.⁶¹

7. Dëshmitë publike

- Dëshmitë publike të viktimave do të na

53 Naser Kadriu, član poro-dice žrtava, Kosovo, Lokalne konsultacije s udruženjima žrtava, Mitrovica/Mitrović, Kosovo, 5. septembar 2009.

54 Milorad Zimović, Shoqata për kërkimin e të pagjetur-ve, Brčko, Konsultimet me bashkësinë lokale, Brčko, BeH, 5 dhjetor 2009.

55 Samir Palić, Bashkësia lokale Qyteti Kulla në Zvornik, BeH, Konsultimet me bashkë-sinë lokale, Zvornik, BeH, 18. korrik 2007.

56 Liridon Jetishi, student i Fakultetit të shkencave poli-tike dhe Fakultetit Juridik, Prishtinë, Kosovë, Konsultimet nacionale me studentët stu-dentë, Prishtinë, Kosovë, 15 prill 2009

57 Veljko Mandić, Shoqata e luftëtarëve antifashistë, Kroatia, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, Kroatia, 22 shta-tor 2009.

58 Zoran Šangut, Shoqata e juristëve Vukovari, Kroatia, Konsultimet nacionale me të ndaluarit dhe burgosurit në qendrat e mbajtjes, Sarajevë, BeH, 10 dhjetor 2009

59 Ibrahim Bušatlija, Këshilli i kongresit të intelektualëve boshnjak, Sarajevë, BeH, Konsultimet nacionale me intelektualët, Sarajevë. BeH, 7 nëntor 2009.

60 Velimir Lipovan, avokat, Srbija, Konsultimet me bashkësinë lokale, Kikindë, 17. tetor 2009.

61 Zdravka Karlica, Organizata republikës e familjarëve të zënë peng dhe luftëtarëve të vrarë dhe civilëve të pagjetur të Republikës Serbe, këshilli në Prijedor, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10. tetor 2009.

62 Teufika Ibrahimfendić, Shoqata Vive gratë, Tuzla, Konsultimet nacionale me grupet e grave, Tuzla, BeH, 11. nëntor 2009.

63 Vehid Šehić, Forumi i qytetarëve nga Tuzla, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, 3. tetor 2009.

64 Mario Mažić, Iniciativa për të drejtat e njeriut në Kroaci, Konsultimet nacionale me të rinjtë, Banja Luka, BeH, 17 tetor 2009.

65 Amir Kulaglic nga Srebrenica, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10. tetor 2009.

66 Rada Borić, Qendra për Studime Gjinore, Zagreb, Kroaci, Konsultimet nacionale me organizatat e grave, politikanëve, artisteve, gazetarëve, Beograd, Serbi, 9. tetor 2009.

ndihmojnë të kuptojmë se çfarë iu ka ndodhur të tjerëve.

- **Duhet të dëgjohen tregimet e të gjitha viktimave. Ky është respektim e jo barazim.**
- **Prioritet është që në Kroaci të dëgjohen dëshmitë nga Knini e në Serbi dëshmitë nga Vukovari.**
- **Vlera më e madhe e KOMRA-s është që të mundësohet të rinjëve dhe gjeneratave të ardhshme të kuptojnë e gjitha ajo çfarë ka ndodhur nëpërmjet tregimeve të njerëzve nga hapësira e tërë ish-Jugosllavisë.**
- **Dëshmia publike e viktimave na ndihmon të ndiejmë dhimbjen e të tjerëve dhe ndërtojmë solidaritetin në mes të viktimave.**

Ne të gjithë këtu, veçmas këta nga Prijedori, por edhe këta njerëz përreth e dinë se çfarë ka ndodhur në Prijedor (...) Dhe unë thash herën e kaluar se gjumë gjëra, besoni, nuk i kam ditur derisa nuk nisa të vij këtu dhe t'i dëgjojë viktimat çka po flasin. E pash kur ky djaloshi i ri, ulur pranë meje, Sudbini, tregoj krejt çfarë i ka ndodhur atij. Dhe unë nuk di sa here e kamë kthyer atë at CD dhe shikuar. Dhe, t'u them sinqerisht dëshmia e tij dhe gjithë ajo që tha, fatkeqësisht ai krejt e ka përjetuar atë, më jep shpresë se megjithatë do të mund të arrijmë deri tek e vërteta mbi gjithë atë që ka ndodhur.⁶²

(...) Nuk dua të përziej në atë që ka ndodhur në Kalinovik, çfarë ka ndodhur në Konjicë, në Mostar, sepse ato gjëra nuk i di. Dua ti pranojë me respekt, jo me vlerësim, jo me cilësimin se rrëfimi im është më i rëndë, rrëfimi im është tjetër faresh e kështu me radhë. Kjo është mënyrë e vetme. Ky nuk është njëjtësim, sepse ne e dimë çka na ka preokupuar më së shumti, Srebrenica dhe fillimi i luftës, edhe Kapija dhe Markalle në Sarajevë e kështu më radhë, kjo domethënë ku kanë ndodhur krimet që kanë qenë me numër të madh..⁶³

Me këto konsultime sigurisht të trimërojmë njerëzit të flasin. Do t'i trimërojmë në atë mënyrë që përmes

dësgjimit eventual të viktimave të kuptojnë se edhe të tjerët e kanë atë dhimbje për diçka që i ka prekur gjatë luftës dhe aty të afirmojmë parimin e një lloji solidariteti ndërmjet nesh.⁶⁴

(...) të themi (që) ato dëshmitë nga Knini ti dëgjojnë, varësisht nga vitet për të cilat është fjala në Beograd, ti dëgjojnë në Banja Llukë dhe ti dëgjojnë në Zagreb. Që dëshmitë nga Stolci, nga Prozori të dëgjojnë në Zagreb, që dëshmitë nga Vukovari të dëgjojnë në Beograd, Nish, etj..⁶⁵

Dëshiroj që fëmija im një ditë (...) kur të hyjë në internet dhe kur të dëshirojë të mësojë detaje për atë çfarë ka ndodhur në hapësirat ku kanë jetuar prindërit e tij, të mësojë diçka që është më afër të vërtetës, e do të mësojë diç që është më afër të vërtetës ashtu (...) që të vërtetën e vet do ta tregojnë të gjithë njerëzit që kanë marrë pjesë në këtë, respektivisht njerëzit nga këto hapësira (...) dhe mendoj se kjo është vlera më e madhe e këtij projekti. (Vesna Sladojeviq, Radiotelevizioni i Serbisë, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

8. Përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të KOMRA-s

- **Numri i komesarëve duhet të jetë ndërmjet 20 dhe 25.**
- **Numri i komesarëve nga secili shtet duhet të jetë në përputhshmëri me numrin e viktimave**

Numri nuk duhet të jetë tepër i madh. Por nuk guxon të jetë as tepër i vogël. Unë për shembull jam për 20 deri 25 komisarë në përbërje të atij Komisioni. Por jo proporcionalisht, numri i njëjtë nga Mali i Zi, Serbia, Kosova, Bosnja, Kroacia, veç sipas numrit të viktimave (...) Nuk mund të ketë numër të njëjtë në KOMRA të Malit të Zi i cili ka numër shumë të vogël të viktimave në raport me Bosnjën e Hercegovinën.⁶⁶

Duhet patjetër ta zhvillojmë strategjinë kur të vij

moment për propozim, kë do ta propozojmë. Kjo duhet të jetë e unifikuar. Mendoj se do të ishte shumë e rëndësishme që kudo në rajon këtë ta bëjnë ose parlamenti ose kryetari (i shtetit). Bie fjala do të ishte më thjeshtë të ndikohet nëse këtë e bënë kryetari.... Varet kush do të jetë në atë moment. Kujtoj se është tepër e rëndësishme të kemi qëndrim unik për mbarë rajonin, që propozimi të kalojë nëpër të gjitha parlamentet. Kjo është shumë më mirë.⁶⁷

Ai person duhet më parë atë egon e vet, nëse është deri në kulm, ta zbret në xhep dhe të pranojë se ka pasur në popullin e tij ndonjë nga krimet, që të mund ma lehtë ta dëgjojë palën tjetër kur të bëhen dëgjime publike. E jo që në te të aktivizohen emocionet dhe të thotë: ndal, edhe tek ti atje ka ndodhur ky...! Domethënë, më parë gjendja faktike që unë të mund ta shikojë në sy Perën dhe Pera mua. Që unë të mund ta dëgjojë atë si njeri dhe të mund të ai të më dëgjojë mua, tek atëherë mund të bisedojmë mbi KOMRA. Përpara kësaj nuk ka asgjë! Më falni, tek atëherë mund të flasim për rastet tona veç e veç. Duhet të bisedojmë a jemi për KOMRA, kush duhet të jetë aty, çka duhet të jetë aty, e jo cilat janë problemet e mia personale.⁶⁸

Frikohem që të mos shkatërrohet edhe KOMRA sikurse u shkatërrua edhe ish RSFI. Këtë frikë e kam nga fillimi qysh se kam nisur të mendoj për gjithë këtë, ndoshta të huajt duhet të kenë implikim vetëm që të shikojnë që ky të mos shkatërrohet.⁶⁹

Ajo për të cilën folët rreth asaj se kush i zgjedh anëtarët e Komisionit, kush do ti propozojë, kush do të jenë ata njerëz, çfarë do të jetë integriteti tyre etikë, më duket se nuk do të mund ta pengojë që megjithatë korpusi i fuqishëm i fakteve të mblidhet dhe historianëve e teoricienëve të ardhshëm tu ofrohet mundësia që realisht ta përpunojnë, të gjenden fjalë të mirëfillta, që të përshkruhet ajo që ka ndodhur në këto territore dhe të gjenden terma adekuate se që janë këta juridik me të cilët po shërbehemi tash.⁷⁰

9. Dokumentimi

- KOMRA do të ketë problem të sigurojë të

dhënat dhe dokumtet në pronësi të organeve shtetërore.

Ky komision nuk guxon të ketë mandat të stërzgatur, por aty vie në pah rëndësia e organeve, organeve zyrtare të cilët tanimë funksionojnë dhe për afërsisht merren me këto çështje në vendet e tyre, që thjeshtë të hapin arhivat e tyre në mënyrë që çdo gjë që kanë ardhur deri tani në mënyrë automatike të jenë të qasshme dhe atëherë mundet në bazë të këtyre standardeve ti qasemi secilit fakt.⁷¹

10. Selia e KOMRA-s

- Selia e zyrës qendrore të KOMRA-s duhet të jetë me rotacion.
- KOMRA duhet të ketë zyret në bashkësitë lokale, fillimisht ku gjendet bashkësitë etnike të cilat jetojnë të ndara njëra prej tjetrës si dhe në bashkësitë të cilat janë të ngarkuara me konflikte.
- Brčko është evnd i mirë për seli të KOMRA-s.

Në rast se KOMRA duhet me qenë e organizuar në atë mënyrë që me pas zyrën qendrore, ku do të duhej të ishte selia e KOMRA-s dhe ku do të vendoseshin zyrat përfaqësuese (...) propozimi im është që selia e KOMRA-s të vendoset me rotacion.⁷²

Unë vij nga bashkësia e ndarë kombëtare dhe shkoj në shkollë e cila është e etiketuar si dy shkolla nën një kulm. Dhe pikërisht angazhohem për këtë lokale e primare. Domethënë, KOMRA-n lokale. Kjo është ide ekstra, sepse (...) nëse ne e zgjidhim këtë në bashkësinë lokale, shumë lehtë kjo do të mund të shtrihet në shkallë shteti.⁷³

Vetëm një sugjerim i shkurtër lidhur me qendrën KOMRA, veç si e quani komitet rajonal. Mendoj se Bërçko imponohet vetvetiu pasi që nuk është askund, e është gjithkund. Domethënë, doshta gjithkund do të ekzistojë ndonjë përpjekje e trysnisë politike të këtij apo atij pushteti. Falë rrethanave në atë qytet të bukur, i cili përndryshe gjeografikisht është pozicionuar bukur, mendoj se aty më

67 Mirsad Dizdarević, Lidhja e të ndalurve dhe burgosurve në qendrat e ndalimit BeH, Jajce, konsultimet nacionale me të ndalurit dhe burgosurit në qendrat e ndalimit, Sarajevë, BeH, 10. dhjetor 2009.

68 Dušan Višnjić, Zyra për të rinjtë të qytetit të Shabacit, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Shabac, 13 nëntor 2009

69 Milena Dragičević Šešić, Fakulteti i arteve dramaturogjike, Beograd, Serbi, N, Konsultimet nacionale me organizatat e grave, politikanëve, artistëve, gazetareve, Beograd, Serbi, 9. tetor 2009

70 Veljko Vičević, UDVDR PGZ, Kroaci, Konsultimet lokale me veteranat, Donja Stubica, Kroaci, 28. tetor 2009.

71 Furtuna Sheremeti, Iniciativa e tw rinjve pwr tw Drejtat e Njeriut, Prishtinë, Kosovë, 30. shtator 2009.

72 Avdo Zec, Qendra e tw rinjve Gornji Vakuf/Uskoplje, BeH, Konsultimet nacionale me tw rinjtë, Sarajevë, BeH, 17. shtator 2009.

73 Zoran Živković, Milenijum, Beograd, Serbi, Konsultimet nacionale me organizatat jo-qeveritare, Beograd, Serbi, 17. dhjetor 2009.

74 Biserka Momčinović, Qendra për iniciativa qytetare, Poreç, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pula, Kroaci, 1 korrik 2009

75 Slavko Kecman, Shoqata për Paqe në Baranj, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Osijek, Kroaci, 17. tetor 2009.

76 Damir Šimić, TV BH1, BeH, Konsultimet regionale me gazetarë, Novi Sad, Serbi, 26. shtator 2009.

77 Venera Ramaj, Integra, Kosovë, Konsultimet nacionale me të rinjtë, Prishtinë, Kosovë, 30. shtator 2009.

*pak është e mundshme që ndonjë garniturë politike të ushtrrojë trysni. Si seli, po. Testoni entuziazmin e komisarëve potencial.*⁷⁴

11. Marrëdhëniet me gjyqësinë

- KOMRA mundet të nxisë gjykimet në shpejtësi, me cilësi dhe pejtësi t'i procesojë.
- KOMRA do të hetojë krimet e luftës të cilat deri tash nuk janë procesuar.
- KOMRA duhet të ketë bashkëpunim të ngushtë me organet e drejtësisë.
- Prokuroritë duhet me ligj të obligohen të përcjellin dhe përdorin dokumentacionin të cilin do ta mbledhë komisioni i ardhshëm gjatë mandatit të tij.

*Nga KOMRA pres është një presion shtesë, edukim, ngritje të vetëdijës në shoqërinë tonë, e veçanarisht në gjyqësi. Sepse, mendoj se vet fakti se prap do të evidentohen të dhënat ndoshta ndonjë lëvizje do të ndodhë edhe në gjyqësinë tonë në shpejtësi dhe cilësi të gjykimet.*⁷⁵

Për shumicën e këtyre krimeve që janë bërë në territorin e Komunës Zvornik ... po zhvillohen disa procese gjyqësore. Ato janë në zhvillim e sipër, por për shumicën e atyre krimeve ende askush nuk është përgjigjur (...) Domethënë, komisioni duhet të ketë bashkëpunim më të ngushtë me prokuroritë për shkak të, ashtu të them, dërgimit sa më të shpejtë të fakteve dhe të dhënave mbi krimet e luftës. (Mevludin Lupiq, Shoqata e Familjeve të personave rob e të pagjetur të Komunës Zvornik, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2007)

*Këtë po e flas për shkak se të gjitha prokuroritë publike, do të ishin të detyruara ta përcjellin ligjshëm atë që e bënë komisioni. Domethënë komisioni është shumë i rëndësishëm edhe për aspektin e të drejtës ndëshkuese dhe politikës penale.*⁷⁶

12. Pengesat

- Shtetet në regjion të cilat nuk pranojnë faktet të cilat i ka përcaktuar Tribunali i Hagës vështirë që do të përkrahin iniciativën për krijimin e KOMRA-s.
- Ekziston dyshimi që Kosova dhe Serbia nuk do të vendosin bashkëpunim në drejtim të konstatimit të fakteve pa marë parasyshë kush do të jetë anëtar i KOMRA-s.
- Një ndër problemet për themelimin e KOMRA-s mund të jetë edhe ajo se ndonjë nga shtetet në regjion mos ta njohin Kosovën.
- Pengesa më e madhe për qartësimin e të kaluarës janë politikanët dhe opinioni publik të cilët të dënuarit e "tyre" për krime të luftës i shohin si heronjë.
- Përmendoret viktimave dhe kryerësve çfare po iu ndërtohen në BeH po thellojnë ndarjen ndërmjet popujve.
- Në përmendoret viktimave në Kosovë shihet dhunë. Të gjitha viktimat janë me armë. Do të ishte më mirë të tregohet se Öfarë ka ndoshtur në të kaluarën e jo të nxiten të rinjtë kundër një populli.
- Ndoshta është shumë herët që qeveritë të krijojnë komisionin e cila do të bëjë punën e saj.

*Pra, janë të pakontestueshme faktet se Gjykata e Hagës i ka konstatuar faktet në të gjitha palët, por ato në realitet nuk i pranojnë politikën dhe për këtë shkak mendoj se do të jetë shumë vështirë të binden qeveritë e vendeve të cilave vështirë do të mund tu qaseni me këtë projekt.*⁷⁷

Unë jam skeptike në bashkëpunimin [e Serbisë dhe Kosovës], për arsye se e dimë që bashkëpunimi për gjetjen e fakteve në Kosovë, shkon faktikisht drejtpërdrejt me Serbinë, për shkak se shumica e fakteve për të cilat ne jemi të interesuar, gjenden atje. Unë

jam skeptike në atë se sa mund të bashkëpunojmë me ta, sa munden të na ofrojnë ndihmë, në zbulimin e fakteve të cilat neve na interesojnë. Për këtë, unë e kam një dyshim të madh, një pikëpyetje shumë të madhe se sa mund të jetë efikas kjo dhe sa ju faktikisht besoni se ajo mund të jetë frytdhënëse, pa marrë parasysh çfarë persona zgjedhën për atë koalicion.⁷⁸

KOMRA si (...) komision rajonal i cili duhet të formohet me marrëveshje ndërkombëtare, si mund t'i tejkalojë problemet e quajtura anëtarësim të Sllovenisë, e së shpejti edhe të Kroacisë, në Bashkimin Evropian dhe mosnjohja ndërkombëtare e Kosovës vetëm si vend ku duhet të hulumtohen shkeljet e të drejtave të njeriut?⁷⁹

Dhe në fund të fundit edhe kriminelët e luftës të dënuar, mendoj në ata të Hagës, janë kthye me ngadhënjim në mjedisin e vet dhe atë jo vetëm pse kjo është pjesë e manipulimit, veç që kjo është ndjenjë e opinionit publik.⁸⁰

(...) këtu në një qytezë, jo larg Sarajevës, një kriminel lufte pritet në stadium me flamuj e muzikë. Një tjetër pritet në ndërtesën e Presidencës së Bosnjës e Hercegovinës. Për një të tretin shkojnë avionët. Dhe nuk jam i sigurt se strukturat shtetërore mund të japin ndonjë kontribut në vërtetimin e fakteve.⁸¹

Unë e di se kur shkojmë (...) në Bosnjën Lindore (...) këtu (...) kanë bërë atë e këtë, dhe registri. Duhet shënuar përmendoren. Përmendorja si përmendore është përmendore dhe dihet për çka dhe çfarë qëndrimi duhet pasur ndaj saj. Mirëpo, kështu si po punohet, ne (...) po e thellojmë hendekun që është prezent.⁸²

Në Kosovë (...) në ato lapidare qartë shihet dhuna. Ato janë të ndërtuara me armë dhe ato janë të vendosura nëpër qendra të vendeve (...) ku fëmijët kanë qasje vizuale tërë kohën dhe ajo gjatë rritjes së tyre mund tua pjek një ide, një ide kundër një kombi tjetër i cili gjithmonë ka me qenë i keq deri në vdekjen tone. A ka ndonjë plan konkret për këto memoriale, që të jenë në nivel nacional por që nuk i irriton personin drejtpërdrejt në aspektin të asaj që ka ndodhur më herët.⁸³

(...) ne jemi dëshmitarë se për gjëra shumë më pa djallëzore pushteti nuk dëshiron ta kyç në cilindo trup askënd i cili ka integritetin dhe qëndrimin e ve. (...) E lërë më ti procedojmë krimet e luftës, dhe që pushteti në atë komisioni ta instalojë ndonjë levë, ndonjë intelektual apo njeri të mendimit të lirë, të guximshëm dhe përgjegjës të cilët e dine këtë... ndoshta ende është shumë herët që pushtetet ti formojnë këto komisione, e formalisht mund të kemi Komisionin i cili nuk do ta kryej punën e vet.⁸⁴

78 Damir Salkić, Iniciativa e të rinjëve për të drejtat e njeriut në Bosnje e Hercegovinë, Sarajevë, BeH, konsultimet nacionale me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17. shtator 2009.

79 Zdravko Grebo, profesor, Fakulteti Juridik në Sarajevë, BeH, Konsultimet nacionale me intelektualë, Sarajevë, BeH, 7 nëntor 2009

80 Josip Muselimović, avokat nga Mostari, BeH, Konsultimet nacionale me intelektualë, Sarajevë, BeH, 7 nëntor 2009.

81 Salih Rasavac, Corridor, Sarajevë, BeH, Konsultimet nacionale me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009

82 Korab Krasniqi, Integra, Prishtinë, Kosovo, Konsultimet nacionale me të rinjtë, Prishtinë, Kosovë, 30. shtator 2009.

83 Stanko Marić, Senat U

PËRMBAJTJA

1. Hyrje	1
2. Kredibiliteti dhe legjitimiteti i Iniciativës për themelimin e KOMRA-s	2
3. Përkrahja qasjes regjionale	2
4. Qëllimet e KOMRA-s	4
4.1. Pajtimi	4
4.2. Përcaktimi i fakteve mbi krimet e luftës dhe shkaktarët e luftës.....	5
5. Mandati KOMRA-s	7
5.1. Mbikëqyrja kohore	7
5.2. Vrste krësenja	8
5.3. Autorizimet	9
6. Aktivitetet e veçanta të KOMRA-s	10
7. Dëshmitë publike	11
8. Përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të KOMRA-s	12
9. Dokumentimi	13
10. Selia e KOMRA-s	13
11. Marrëdhëniet me gjyqësinë	14
12. Pengesat	14